



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT/KANCELARIJA PRESEDNIKA/PRESIDENT'S OFFICE/BASKAN OFISI

Në pajtim me nenin 58 pika h) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 77 nën paragrafi 1.8 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008 dhe në zbatim të nenit 6 nën paragrafi 2.1 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal dhe nenit 5 nën paragrafi 1.1 i Rregullores nr. 09/2013 për Nxitjen e Bashkëpunimit Ndër-komunal, **Kryetari i Komunës së Gjilanit** paraqet:

INICIATIVËN

PËR NXITJEN E BASHKËPUNIMIT NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E NOVOBËRDËS NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE NDRIÇIM PUBLIK, KANALIZIM, UJËSJELLËS E TJ. ME INTERES TË PËRBASHKËT

1. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunën e Novobërdos.
2. **Qëllimi i bashkëpunimit**- bashkëpunimi do të bëhet në fushën e infrastrukturës rrugore, ndriçim publik, kanalizim, ujsjellës, trotuar dhe projekte tjera me interes të përbashkët për komuna e Gjilanit dhe të Novobërdës.
3. Bashkangjitur me iniciativën do të paraqesim mendimin me shkrim dhe të arsyetuar dhe vendimin për miratimin e nismës nga Kuvendi i Komunës me të cilin vendim për miratim të iniciativës do të njoftohen kryetarët e komunave me të cilët tentojmë të kemi bashkëpunim ndër-komunal.
4. **Arsyetimi**- Komuna e Gjilanit dhe Komuna e Novobërdos kanë shprehë paraprakisht vullnetin e tyre për bashkëpunim dhe janë pajtuar që përmes zyrave të projekteve përkatëse dhe të drejtorive rrespektive të komunave të bashkëpunojnë në sferën e infrastrukturës sipas nevojës në realizimin e projekteve me interes të përbashkët për të dy komunat. Rregullimi i infrastrukturës iu mundëson dhe lehtëson fshatrave të kësaj ane që popullata lokale të komunikojnë me lehtë me qendrën komunale të Gjilanit dhe qendrën komunale të Novobërdos.

Komunat do të aplikojnë bashkërisht tek Ministria e Infrastrukturës dhe donatorët tjerë të mundshëm, me qëllim të realizimit të këtij projekti me interes të përbashkët.



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT/SKUPŠTINA OPŠTINE GNJILANE/

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38 nën paragrafi 1.4 dhe nenit 46 nën paragrafi 2.11 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 016-126211 të dt 06.11.2014 dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për Bashkëpunim Ndër-komunal dhe të nenit 6 nënparagrafi 1.7 të Rregullores nr. 09/2013 për nxitjen e bashkëpunimit ndër-komunal, **Kuvendi i Komunës së Gjilanit** në seancën e mbajtur më 28.07.2016, miraton:

N I S M Ë N

E KRYETARIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E NOVOBËRDËS NË FUSHËN E INFRASTRUKTURËS RRUGORE, NDRIÇIM PUBLIK, KANALIZIM, UJËSJELLËS E TJ. ME INTERES TË PËRBASHKËT

1. Miratohet iniciativa e Kryetarit të Komunës së Gjilanit për bashkëpunim ndër-komunal me Komunën e Novobërdës në fushën e infrastrukturës rrugore, kanalizim, ujsjellës, ndriçim publik, trotuar etj. në realizimin e projekteve konkrete të hartuar nga të dy komunat.
2. Bashkëpunimi ndër-komunal do të zhvillohet me Komunën e Novobërdës.
3. Detajet e bashkëpunimit do të përcaktohen me marrëveshje të bashkëpunimit.
4. Ky akt hyn në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal si dhe pas publikimit në web faqen e Komunës së Gjilanit.

01. nr. 016-74711
Gjilan, më 28.07.2016

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE
MUNICIPALITY OF GJILAN
GILAN BELEDIYESI

KUVENDI I KOMUNËS SË GJILANIT/SKUPŠTINA OPŠTINE GNJILANE/

Në pajtim me nenin 12 pika d), nenit 40 pika j) të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenit 38 nën paragrafi 1.4 dhe 46 nën paragrafi 2.11 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008 dhe në zbatim të nenit 7 të Ligjit nr. 04/L-010 për bashkëpunim ndër-komunal, **Kuvendi i Komunës së Gjilanit** në seancën e mbajtur më 28.07.2016 , miraton:

V E N D I M I N

**PËR AUTORIZIMIN E KRYETARIT TË KOMUNËS SË GJILANIT PËR
BASHKËPUNIM NDËR-KOMUNAL ME KOMUNËN E NOVOBËRDËS NË FUSHËN
E INFRASTRUKTURËS RRUGORE NDRIÇIM PUBLIK, KANALIZIM, UJËSJELLËS E
TJ. ME INTERES TË PËRBASHKËT**

1. **AUTORIZOHET**, Kryetari i Komunës së Gjilanit për t'i filluar konsultimet me Komunën e Novobërdës, dhe në bazë të këtyre konsultimeve ta përgatisin propozim-marrëveshjen për themelimin e bashkëpunimit ndër-komunal.
2. Pas marrjes së autorizimit, Kryetari i Komunës së Gjilanit e njofton Kryetarin e Komunës gjegjëse për nismën me të cilin kërkohet themelimi i bashkëpunimit ndër-komunal.
3. Ky akt-autorizim hyn në fuqi me aktin e nënshkrimit nga Kryesuesja e Kuvendit të Komunës së Gjilanit.

01. nr. 016-74720
Gjilan, më 28.07.2016

Kryesuesja e Kuvendit

Valentina Bunjaku-Rexhepi